

SHFMU “Zenel Hajdini” Gadime

Historiku i shkollës

16 qershori dita e shkollës

Arsimimi në këtë trevë filloi përmes një mejtepi fetar themelues i të cilit ishin Muharrem Jupaj nga Gadimja e Ulët dhe Ismajl Efendiu nga Prishtina.

Në vitin 1926 me Vendimin e Ministrisë së Arsimit të Jugosllavisë së vjetër nr.72841 hapet pralelja e parë në Gadime me 37 nxënës me mësuesin nga Kragujevci Ivan Trifunoviq. Mësimi zhvillohej në gjuhën serbokroate.

Në vitin 1935 me iniciativën e Osman Jupës nga Gadimja e Ulët dhe Vesel Sejdija nga Gadimja e Epërme me vetkontributin e fshatarëve në mes të dy fshatrave ndërtohet objekti i ri shkollor me tri mësojtore. Mësuesi i parë ishte Bogolub Zokiqi, ndërsa në vitin 1937 vie mësuesja Maria Jovanoviq. Më 1940 numri i nxënësve arrinë në 68, por duhet theksuar se mësimi ende zhvillohej në gjuhën serbokroate.

Muaji Maj i vitit 1941-42 për Gadimasit është vit kthese ngase për herë të parë nxënësit e këtij lokaliteti fillojnë të mësojnë në gjuhën amtare, pra në gjuhën shqipe. Mësuesi i parë ishte Ruzhdi Spahiu. Në vjeshtë të po këtij viti hapen edhe dy paralele me 63 nxënës.

Pas Luftës së Dytë Botërore mësuesi i parë i kësaj shkolle ishte Ruzhdi Spahiu, pastaj mësuesit Ruzhdi Guranjaku nga Shqipëria, Kadri Greca nga Shqipëria, Sabit Dema nga Gadimja e Epërme, Shaban Kajtazi, Hulë Siruna, Qemajl Ratkoceri e shumë të tjerë.

Në vitet 1950,1953 dhe 1954, Gjimnazin e ulët në këtë shkollë vijonin mësimin nxënësit e 13 fshatrave të kësaj treve, përveq nxënësve Gadimas vijonin edhe nxënësit e këtyre fshatrave përreth: Llugaxhi, Rubovc, Babush i Muhaxherëve, Mirashë, Crmillë, Marevc, Gllavicë, Vrellë, Plitkoviq, Smallushë dhe Slllovi.

Në vitin 1953/54 del gjenerata e parë e cila kryen klasën e tetë. Në vitin shkollor 1962 me Vendimin e organit kompetent të Komunës dhe të Gjykatës Komunale nr.03-5022/1, shkolla 8 tetë vjeqare në Gadime merr emrin e heroit të popullit “Zenel Hajdini” dhe këtë emër e mbanë me krenari edhe sot e kësaj dite. Këtë shkollë e udhëhoqën dhe menaxhuan këta drejtor: Sherif Ahmeti, Shyqeri Reçica, Hysen Tmava, Nazmi Reçica, Rasim Islami, Fehmi Jupa, Sabri Tasholli, Shukri Salihu, Fehmi Ibrahim, Abdurrahman Ejupi, Shemsi Tasholli, Shukri Ibrahim dhe tani Skender Ademi.

90 vite është rrugëtimi i kësaj vatre diuturie, e mundimshme, jo e lehtë dhe me përgjegjësi e sakrificë të ndryshme për të gjithë mësime dhe edukimin e gjeneratave të ndryshme. Nga bankat e kësaj vatre diturie kanë dalë kuadra të profileve të ndryshme, deri te doktorët e shkencave.

Shkolla Filllore e MU “Zenel Hajdini” në Gadime në gjiun e vet ka edhe tri paralele të ndara fizike në Gllavicë-Marevc (katër klasëshe), në Vrellë (me klasë të kombinuara I-II-III-IV).

Në këtë vit shkollor 2020-2021 shkolla është e organizuar dhe punon në 3 nivele: parafillor, fillor dhe i mesëm i ulët. Shkolla numron gjithsej 720 nxënës të shpërndarë në 37 paralele, me 58 punëtor, 44 mësime dhe, 9 punëtor teknik, Drejtori, Zv. Drejtori, Administratorja dhe një shofer. Vlen të theksohet se përopos nxënësve të komunitetit shumicë shqiptar, në shkollën tonë ndjekin mësime edhe nxënës të komunitetit ashkali, prej tyre gjithsej janë 105.

Pësoneli arsimor është i kualifikuar dhe punon me përkushtim në arsimimin dhe edukimin e nxënësve. Nota mesatare e nxënësve të gjysmëvjetorit të parë është 3.55. Përopos mësimit të rregullt, në shkollë me sukses zhvillohen edhe aktivitetet e lira: si grupi letrar, grupi i recitatorëve, grupi muzikor, grupi sportiv, matemacientët e rinjë, grupi i vullnetarëve etj.

Gjatë kësaj kohe që nga viti 2018 e kënde është investuar jashtezakonisht në infrastrukturën e shkollës, ku është bërë renovimi i sallës së sporteve, gjithashtu është bërë izolimi dhe fasadimi i shkollës, është bërë shpërndarja e digjitalizimit të shkollës përmes kamerave në tërë ambientin shkollor. Po ashtu, është ndërtuar edhe fusha sportive në natyrë, për shkak të mbajtjes sa më të pastër ambientin e shkollës, janë renovuar komplet nyjet sanitare të shkollës. Transformimi i oborrit të shkollës është kryer në vitin 2020, ku është vendosur edhe trotuari brenda oborrit të shkollës. Sa i përket një mësime sa më cilësore dhe sa më të hershme, kemi bërë hapjen e një Qendre me komunitet ku pretendohet që nga mosha 3-5 vjeç të kemi një arsimim të femijëve tanë. Kemi paraqitur gjithashtu se shkolla jonë pretendon një mësime gjithëpërfshirje, andaj komuniteti ashkali ka po ashtu një Qendër që ju ofrohet 5 ditë të javës mësime shtesë nga mësime dhe profesional.

